

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**KOMUNËN RRASHBULL, DURRËS**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Rrashbull, Durrës**, me objekt: “*Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fondet publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, etj*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 65, datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, date 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 309/9, datë 30.6.2014, i ka rekomanduar z. Hysen Gashi Kryetar i Komunës, zbatimin e masave të mëposhtme:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

1.-Të zbatohen detyrat dhe rekomandimet e kontrollit të KLSH-së lidhur me nxjerrjen e urdhrat nga Kryetari i Komunës për zbatimin e masës administrative për zj.Vahide Gruda në vlerën 50,000 lekë në zbatim të rekomandimeve të KLSH lënë në auditimin e mëparshëm.

*Menjëherë*

2.-Të hartohet plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, plani strategjik, të përcaktohen objektivat dhe hartohen plan veprimet afatshkurta në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”.

*Deri në 31.7.2014*

3.-Të hartohet strategjia e zhvillimit ekonomik dhe sektorial dhe të ngrihen dhe funksionojnë ekipet përkatëse të menaxhimit, si dhe të merren në konsideratë këto dokumente për hartimin e PB-ve dhe PBA-ve në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor*”.

*Deri në 31.7.2014*

4.-Të hartohen, përditësohen e miratohen Rregullorja e Funksionimit të komunës, e strukturave vartëse dhe Organigrama e Komunës në përputhje me Strukturën Organizative dhe të hartohen rregulloret e Strukturave të vartësisë, harmonizuar me përmbajtjen, përcaktimet, përshkrimet e vendeve të punës, si dhe të përcaktohen detyrimet ndaj Zyrave dhe Strukturave përkatëse si, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Kadastra, Pyjet, dhe Zyrës Planifikimit Urban për Administrimin menaxhimin, vënien në efikasitet të aseteve, inventarizimin fizik, gjendjen teknike të aseteve të llojit, ndërtesa, troje, resurseve toka bujqësore, pyje-kullota, në zbatim të ligjeve nr. 9936, datë 26.6.2008, nr. 10296, datë 8.7.2010.

*Menjëherë*

5.-Të sigurohet zbatimi i procedurave lidhur me përgatitjen dhe hartimin e projekt buxheteve në kohë, në përmbushje të gjithë funksioneve, llogaritje të saktë të Buxhetit nga të ardhurat me përfshirje e mobilizim të ardhurave nga asetet dhe resurset si dhe të sigurohet një evidentim dhe ndjekje e saktë dhe realizim i plotë si dhe vlerësim e zbatim i njëjtë i buxhetit vendor dhe qendror, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor*”.

*Vazhdimisht*

6.-Në rastet e marrjes në dorëzim të punimeve të ndërtimit, shërbimeve të kryera dhe marrjes së mallrave e materialeve në dorëzim, të ngihet një komision me urdhër të veçantë, me të paktën 3 specialistë të fushës, sipas kërkesave të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*Vazhdimisht*

7.-Nga Njësia e Prokurimit të cilësohet në dokumentet e tenderit kërkesa që operatorët ekonomikë të paraqesin vërtetim për shlyerjen e taksave e tarifave vendore në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku ato kanë seli dhe zhvillojnë veprimtarinë.

*Vazhdimisht*

8.-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejt kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organe kompetente.

*Vazhdimisht*

9.-Për të pasqyruar veprimtarinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të mbahen procesverbale për çdo hap të zhvillimit të tenderit, në mënyrë që të bëhet e mundur transparenca dhe auditimi i tenderit në çdo kohë.

*Vazhdimisht*

10.-Të merren masa që të ardhurat e parashikuara në paketën fiskale nga Këshilli i Komunës, të cilat nuk janë programuar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të planifikohen e të arkëtohen në vitin në vazhdim.

*Menjëherë*

11.-Të merren masa dhe të arkëtohen detyrimet nga familjarët në zonën e Shkëmbit të Kavajës si dhe në fshatrat e komunës ku kryhet shërbimi i largimit të mbeturinave urbane, konkretisht në fshatin Xhafzotaj me 981 familje dhe në fshatin Shkallnur me 881 familje, ku nga mos programimi janë krijuar **të ardhura të munguara për komunën në shumën totale 1,841 mijë lekë nga e cila:-**për vitin 2012 shuma **871 mijë lekë dhe** për vitin 2013 në shumën **970 mijë lekë.**

*Menjëherë*

12.-Të sigurohen të dhëna dhe të programohen të ardhura nga taksa për ndërtesat (banesat) dhe nga tarifa e largimit të mbeturinave urbane në zonën e Shkëmbit të Kavajës në përputhje me nenin 24 “Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave” të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, në paragrafin e fundit të tij i cili përcakton se: “... në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, këshilli i bashkisë ose komunës vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme...”

*Menjëherë*

13.-Drejtoria e financës dhe ajo e Shërbimeve, të zbatojë limitin për ruajtjen e mjeteve monetare, të marrë masa për zbatimin e procedurave ligjore për blerjet me vlera të vogla me sistemin elektronik dhe të hartohet regjistri i prokurimeve, në zbatim të pikës 2 Kreu VI, të VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

*Menjëherë*

14.-Nga Këshilli i Komunës të analizohet dhe sistemohet vlera prej **455,034 lekë** shpenzuar për pritje e përcjellje, dhënie “qytetar nderi” dhe me programin e paraqitur organizim të festës 100 vjetorit të Pavarësisë, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

*Menjëherë*

15.-Nga Drejtoria e Financës të merren masa, që në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të administratës, të krijohet regjistri i aktiveve të qëndrueshme fizik dhe elektronik ku të përcaktohen të dhënat e nevojshme si: data e hyrjes apo marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes nga përdorimi, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale në rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën

e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimit të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia, në zbatim të kapitullit III, pika 30 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*Menjëherë*

**16.-**Të rishikohen kontratat e qiramarrjes së objekteve për shkolla e kopshte duke mbajtur parasysh që në caktimin e vlerës së qirave llogaritjet të kryhen bazuar në kriteret e VKM nr. 138 datë 23.3.2000 i ndryshuar, në VKM nr. 563 datë 3.8.2011 pika 2 dhe pika 3 si dhe në kriteret e VKM nr. 187, datë 8.3.2013 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë.

*Menjëherë*

**17.-**Të rishikohen dhe të vendosen normativat e konsumit të karburantit, bazuar në librezat dhe kapacitetin e mjetit, volumin e cilindrave dhe distancën e rrugës në udhëtim brenda dhe jashtë qytetit, si dhe volumin e punës.

*Menjëherë*

**18.-**Të hartohen fletët e udhëtimet ditore dhe të shënohen e nënshkruhen kilometrat e përshkuar për çdo rrugë, si dhe për mjetin “Fadromë” të përcaktohet norma e konsumit ndërsa në procesverbalet për punimet e kryera, të përcaktohen volumet e punës mbështetur në plan vendosje apo skica në dimensionet, me gjatësi dhe kuota, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 3 dhe 5 të ligjit nr. 8402, datë 17.09.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

*Menjëherë*

**19.-**Nga Komuna Rrashbull të kryhet strukturimi dhe përshtatja e strukturës me numrin e nevojshëm të **inspektorëve të policisë**, në bazë të vendimeve të komisionit të posaçëm për emërimin e inspektorëve dhe të asistuar si dhe të rritet efienca dhe bashkëpunimi i strukturës sipas përcaktimeve në ligjin **nr 8224, datë 15.05.1997, i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”.**

*Menjëherë*

**20.-**Nga Këshilli i Komunës, Rrashbull dhe Kryetari i Komunës të analizohen e ndërmerren hapat e duhur ligjore për zbatimin dhe ezaurimin e masave dhe vendimeve të propozuara nga INUV për periudhën 2012-2013 lidhur me Kontrollin e Territorit, në zbatim të ligjit nr. 9780 datë 16.7.2007 “Për Inspektoratin e Ndërtimit”, ndryshuar me ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe të VKM nr. 862, datë 5.12.2007 “Për Unifikimin e Procedurave të Kontrollit të Territorit nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar e Vendor”.

*Menjëherë*

**21.-**Nga Komuna Rrashbull të mbahet bilanci i fondit të tokës shprehur në sipërfaqe në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore (ku evidentohen mbi 3600 ha), fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës-truall, dhe çfarëdo lloj fondi tjetër tokësor ( si zë kadastral) në diskonim/administrim të Komunës, të pasqyrohen ndryshimet apo kalimet në kategori të zërave të fondit të tokës dhe resurseve nga lejet e ndërtimit, të pasqyrohen në inventarin kontabël, në librin e aktiveve të qëndrueshme pasi të kryhet inventarizimi fizik i pasurive ndërtimore dhe resurseve lidhur me infrastrukturën e mobilimin e tokës objektet si lerat e pirjes ujit bagëtime, kanalizime “Prita malore”, ujëmbledhësit dhe infrastruktura ujitëse si: rrjeti i kanalizimeve ujitëse, rrjeti i kanalizimeve të ujërave të larta, sifonet, mbi të cilat detyrohet të shërbejë Komuna për mirëmbajtjen dhe vënien në efienca në mbështetje të fermerëve, në zbatim të ligjit nr. 8752, datë 28.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar me ligjin nr. 10257, datë 25.3.2010, nenet 11 dhe 11/1 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2010 .

*Menjëherë dhe Vazhdimisht*

**22.-Komuna Rrashbull të hartojë dhe zbatojë** programin vjetor të kryerjes së inventarizimit të plotë fizik, teknik dhe identifikues të asetëve në pronësi përdorim dhe juridiksion të komunës, të llojit pyje, kullota, troje, ndërtesa (pasuri të përfshirë në Listat paraprake për transferim), të hartojë listat përfundimtare e ti dërgojë në Ministrinë e Brendshme dhe të përmbyllë fazën e III-të, si dhe të përfshijë ndërtesat, **3 fusha sporti** e asetet e tjera të transferuara përkatësisht sipas VKM-ve, në zbatim të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

*Menjëherë dhe Vazhdimisht*

**23.-Komuna Rrashbull të marrë në dorëzim sipërfaqen pyjore e marrë më pak prej 21 ha**, të kryejë regjistrimin e pasurive në ZVRPP, inventarizimin dhe kadastrimin, në zbatim të VKM nr. 314, datë 12.3.2008 dhe VKM nr. 877, datë 14.12.2011, si dhe hartojë planet e menaxhimit dhe mbarështimit, të pyje kullotave sipas formës e përmbajtjes tip të Manualit, të përfshijë ato në programet përkatëse dhe në buxhetet si për të ardhurat dhe shpenzimet, të evidentohen dhe raportohen zbatimi i planeve në kohë, dokumentohen hyrjet e produkteve drusor, bimor, kullosor; të analizohen e nxirret përgjegjësia dhe arkëtohen të ardhurat e munguara në vlerën **284 200 lekë**, si dhe të merren masat për identifikimin, krijimin dhe mbështetjen e operatorëve të tregut si shoqatat e përdorimit të yjeve, kullotave, gjuetisë, bimësisë etj, për një zhvillim të qëndrueshëm e progresiv, në zbatim të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore përkatëse.

*Menjëherë dhe Vazhdimisht*

**24.-Komuna Rrashbull të vendosë nën administrim dhe të kryejë inventarizimin fizik e teknik, regjistrimin në ZVRPP të veprave ujore, trojeve përkatës ndërtesave dhe aksesoreve, sipas VKM-ve përkatëse. Të marrë masa për vënien në efikasitet, identifikimin, krijimin dhe vendosjen e lidhjeve me operatorët përkatës të tregut** si Shoqata e Fermerëve, shoqata e Përdorimit të Ujit, shoqata e Peshkimit dhe akuakulturës, mosveprime që kanë sjellë si pasojë të ardhura të munguara të analizohen e nxirret përgjegjësia ndaj menaxhuesve të sektorit të pyjeve dhe arkëtohen të ardhurat e munguara **në vlerën 636,000 lekë, ndaj përdoruesve** në zbatim të VKM nr. 567, datë 14.7.2010, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nenin 14 të ligjit nr. 8518, datë 30.7.1999, “Për Ujitjen dhe Kullimin”, me VKM nr. 135, datë 8.3.2006 “Për Procedurat dhe çmimet e dhënies me qira të sipërfaqeve ujore për ushtrimin e veprimtarisë së akuakulturës intensive” dhe me ligjin nr 8652, datë 31.7.200 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore”,

*Menjëherë dhe Vazhdimisht*

**25.-Komuna Rrashbull të marrë masa duke ndjekur hapat, procedurat, fazat për të përmbyllur fazën e tretë** lidhur me hartimin e listave përfundimtare në zbatim të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 dhe konkretisht:

a. Të kryejë inventarizimet, fizike e teknike në terren pra të identifikojë gjendjen juridike e fizike të pasurive të paluajtshme në pronësi, përdorim e juridiksion të përfshijë në Listat objektet, trojet e asetet e tjera, të cilat **historikisht janë në inventarin e komunës**, të zaptuara e nën përdorimin e paligjshëm me ndërtime e kultivime bujqësore nga persona të ndryshëm në **10350 m<sup>2</sup> sipërfaqe** trualli e objekte ndërtimore si dhe të analizohet e nxirret përgjegjësia dhe arkëtohen të ardhurat e munguara për buxhetin e Komunës në **vlerën 4212 mijë lekë** pasqyruar në tabelën “Pasuri dhe prona të pa përfshira në Listat Paraprake nga mosidentifikimi dhe inventarizimi”.

*Menjëherë dhe Vazhdimisht*

b. Të kryejë inventarizimin të marrë nën *administrim dhe vendosë në efencë* të bëjë *identifikimin e marrëdhënieve të pronësisë mbi truallin dhe objektet* mbi të cilat është lejuar përdorimi i pa ligjshëm e zaptimi nga persona i **22 objekteve ndërtimore dhe sipërfaqes prej 503796 m<sup>2</sup> truall nga i cili 10350 në pronësi të Komunës dhe 425 m<sup>2</sup> dhe trojeve në juridiksion, përdorim e pronësi** të komunës që kanë sjellë si pasojë të *ardhurave të munguara dhe cenim të pasurisë “Shtet”*, si dhe të analizohet e nxirret përgjegjësia dhe arkëtohen të ardhurat e munguara për buxhetin e Komunës në *vlerën prej 71065 mijë lekë nga shfrytëzimi dhe përdorimi i jashtë ligjshëm dhe pa titull pronësie të për 2 vitet 2012 dhe 2013*, paraqitur në tabelën nr.”**Gjendja, administrimi Funksionimi dhe Eficenca e Pasurive troje, objekte-prona të ish-Kooperativës bujqësore dhe ish ndërmarrjeve**“, në zbatim të VKM nr. 529, datë 8.6.2011”Për Përcaktimin e Kritereve, Procedurës dhe të Mënyrës së Dhënies me Qira Emfiteozë apo Kontrata të tjera të Pasurisë Shtetërore”, ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, i ndryshuar ”Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit”, VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” VKM nr. 1003, datë 10.12.2010 “Për Miratimin e Listës Paraprake të Pronave të Paluajtshme Publike, Shtetërore, që Transferohen në Pronësi ose në Përdorim të Komunës Rrashbull, të Qarkut të Durrësit”.

#### *Menjëherë dhe Vazhdimisht*

c. **Komuna Rrashbull** të identifikojë, inventarizojë, pasqyrojë në *listat përfundimtare* dhe të përfshijë në inventarin kontabël me vlerën aktuale reale 6 objekte me funksion social kulturore nga të cilat: 2 kopshte fëmijësh, 1 ambulancë dhe 2 shkolla 9/vjeçare, pasqyruar në tabelën “**Objekte troje, ndryshuar nga rikonstruksione e ndërtime që nuk janë pasqyruar saktë në Listat e Pronave dhe në Kontabilitet**”, si dhe të vlerësojë e përfshijë në inventarin kontabël vlerat ndërtimore të objekteve si: *për Rrugët vendore* (vlera e trup rruge, asfalt, bankina, ura e tombina etj); *për varrezat* (vlera e objekteve ndërtesa, mure, rrethues e rrethime me kolona e tela, vlerat e pemëve dekorative, e bimësisë etj.), *për vendstrehimet e tunelet* (vlera e objektit ndërtimor konstruksioni betonarme, muri ndërtimor, portat, ajruesit etj), për **3 fushat e sportit** vlerat fillestare(përbërë nga portat, kanalizimet, rrethimi, etj) për *stacionin e Pompimit Rrashbull* (vlera e truallit e ndërtesës me 47 m<sup>2</sup>, tubacionit metalik *Krahu Shenavlash* me 224 ml dhe *Krahu Rrashbull* 47 ml tub metalik), *për veprat ujore* vlerat e kanaleve ujitëse se bashku me pikat e shpërndarjes etj. Vlerat e lulishteve dhe ambienteve të gjelbëruara me pemët dekorative e bimësinë, lulet etj, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 18, Kreu V, ”Inventarizimi i Vlerave Materiale”, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik.

#### *Menjëherë dhe Vazhdimisht*

**26.**-Nga Komuna Rrashbull, të zbatohen deri ne fund hapat ligjore për shfuqizimin e 3 kontratave qiradhënie të tokës bujqësore të pandarë me sipërfaqen 9,48 ha, nga të cilat: Kontrata Rep. nr. 497, kol. nr. 188/4, datë 27.12.2012, me subjektin “B...” shpk, me përfaqësues A.B., me sipërfaqe **60000 m<sup>2</sup>**, *kontrata* Rep. nr. 486, kol. nr. 185/4, datë 24.12.2012, me subjektin Sh.G. me sipërfaqe **24800 m<sup>2</sup> të dyja noteruar** nga noteri publik Tesy S.Beshiri Durrës, dhe Kontrata datë 24.12.2012 me subjektin A.A. me sipërfaqe 10 000 m<sup>2</sup>, *duke kryer veprimet tek noteri dhe të njoftohet ZVRPP Durrës, për mos regjistrimin e tyre*; pasi kontratat janë me shkelje të procedurave dhe në kundërshtim me UKM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për Procedurat e Dhënies me Qira të Tokave Bujqësore të Pandara”.

*Menjëherë*

## **B . MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.**

1.-Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, nenet 9-14, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Komuna Rrashbull të nxirren aktet administrative, të kryhen kontabilizimet dhe të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën 59,245,416 lekë si më poshtë:

1. Komuna Rrashbull të vlerësojë dëmin e shkaktuar nga vonesa përfundimit të punimeve në objektin “Ndërtim shkolla 9 vjeçare në fshatin Romanat” me sipërmarrëse Shoqërinë “H...” sh.p.k. ku për 60 ditë vonesë penaltiteti **arrin në shumën 3,378,530 lekë**, për të cilat duhet të përgjigjet operatori ekonomik sipërmarrës.

*Vazhdimisht*

2. Të merren masa dhe të arkëtohen detyrimet nga subjektet e biznesit të vogël, në shumën totale **25,541,000 lekë** nga të cilat; **19,021,000 lekë** detyrime dhe **6,520,000 lekë**, penaltitete e gjoba për mos likuidim në afat ndarë sipas viteve: para vitit 2011 për 3 debitorë në shumën **322,000 mijë lekë**, në vitin 2011 për 64 debitorë në shumën **4,284,000 lekë**, në vitin 2012 për 111 debitorë në shumën **7,947,000 lekë** dhe në vitin 2013 për 121 debitorë në shumën **12,988,000 lekë**, sipas tabelës në faqen 87 të Raportit

*Menjëherë*

3. Drejtoria e taksave vendore në bashkëpunim me policinë e Komunës të marrë masa për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore, në shumën **19,814 mijë lekë** nga e cila: për vitin 2012 në shumën 9,512 mijë lekë dhe për vitin 2013 në shumën **10,302 mijë lekë** në zbatim të nenit 23, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore të ndryshuar të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar dhe UMF nr 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

*Menjëherë*

4. Drejtoria e taksave vendore në bashkëpunim me drejtorinë e planifikimit të territorit dhe me policinë e Komunës të marrë masa për arkëtimin “Taksës së ndërtesës nga familjarët” (banesave) të cilat janë realizuar me **diferencë më pak nga programimi 1,097 mijë lekë** duke shtuar edhe detyrimet si pasojë e mosprogramimit të saktë **në shumën totale 6,166 lekë nga të cilat 2,852 mijë lekë për vitin 2012 dhe 3,314 mijë lekë për vitin 2013.**

*Menjëherë*

5. Nga Komuna Rrashbull të llogariten dhe arkëtohen kamatëvonesat në vlerën prej **3,119,680 lekë**, për 40 leje ndërtimi të dhëna në vitet para vitit 2012 dhe të zbardhura në vitin 2012, në zbatim të nenit 51 të Ligjit 8405 datë 17.9.1998, “Për Urbanistikën”, dhe nenit 8 të ligjit nr. 10078, datë 16.2.2009.

*Menjëherë*

6. Në shumën **71,871 lekë**, të cilat duhet ti kthejë shitësi Shoqëria “K...” sh.a., pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, të kontratës së blerjes së karburantit rezultojnë diferenca në çmimin e zbatuar dhe përfitim më tepër, të cilat duhet të arkëtohen.

*Brenda 9 mujorit 2014*

7. Në shumën **92.110 lekë** (pa TVSH), nga Shoqëria “E...” sh.p.k, përfaqësuar nga M.E., pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit me objekt “Rikonstruksion i rrugës në fshatin Romanat-Vorreza”, rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, të cilat duhet të arkëtohen.

*Brenda 9 mujorit 2014*

8. Në shumën 233.616 lekë (pa TVSH), nga Shoqëria “V...-E...” sh.p.k, përfaqësuar nga R.B., pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit me objekt “Ndërtim rruge me cakull fshati Arapaj” rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, të cilat duhet të arkëtohen.

*Brenda 9 mujorit 2014*

9. Në shumën 117,525 lekë (pa TVSH), nga Shoqëria “E...-G...” sh.p.k, përfaqësuar nga z. M.E., pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit me objekt “Rikonstruksion i rrugëve Fllak-Lagja e Gramshiotëve Fshati Xhazvotaj me L-1250 ml dhe D.N. Fshati Shënavlash me L-1180 ml” rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, të cilat duhet të arkëtohen.

*Brenda 9 mujorit 2014*

10. Në shumën 93,120 lekë (pa TVSH), nga Shoqëria “E...-G...” sh.p.k & “A... KONSTRUKSION” sh.p.k, përfaqësuar nga M.E., pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit me objekt “Rikonstruksion i rrugëve Fllak-Lagja e Gramshiotëve Fshati Xhazvotaj me L-1250 ml dhe D.N. Fshati Shënavlash me L-1180 ml” rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, të cilat duhet të arkëtohen.

*Brenda 9 mujorit 2014*

11. Në shumën 357,956 lekë (pa TVSH) nga Shoqëria “E...-G...” sh.p.k, përfaqësuar nga M.E., pasi nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit me objekt “Ndërtim Ujësjiellësi në fshatin Shkallnur, Faza I” rezultojnë diferenca në volume punimesh të pakryera dhe përfitim më tepër, të cilat duhet të arkëtohen.

*Brenda 9 mujorit 2014*

12. Në shumën 100,008 lekë nga K.Gj. pasi ka përfituar më tepër 8334 lekë/muaj nga kontrata fillestare e qiradhënies për objektin Shkolla Manskuri për periudhën 1.1.2013 deri 31.12.2013.

*Menjëherë*

### **C. MASA ADMINISTRATIVE**

Bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 15, ndryshuar me nenin 2 të ligjit nr. 9826, datë 01.11.2007, për shkelje të nenit 7; pikat, 1, 3, 4, 17, 18 dhe 19 të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar; pikat, 8, 8/1, 8/2 dhe 10 të kreut II-të dhe pikat 4, 5 të kreut III-të, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”,

Kryeinspektori Inspektoratit Ndërtimor dhe Urbanistik, pranë Komunës Rrashbull, të marrë masa duke vlerësuar me gjobë mbikëqyrësit e punimeve si më poshtë:

1. **A.Sh.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për dëmin ekonomik në masën 233,616 lekë, të rezultuar nga auditimi i kontratës për objektin “Ndërtim rruge me çakull fshati Arapaj”.

2. **D.M.**, në cilësinë e mbikëqyrëses së punimeve për dëmin ekonomik në masën 357,946 lekë të rezultuar nga auditimi i kontratës për objektin për objektin “Ndërtim ujësjiellësi fshati Shkallnuer, faza I”.

3. **R.S.**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve për dëmin ekonomik në masën 117,525 lekë, të rezultuar nga auditimi i kontratës për objektin “Rikonstruksion rruge fshati Fllakë”.

### **Shënim:**

Për sa i përket shkeljeve e parregullsive të ndryshme të konstatuara në prokurimet si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuara dhe pasqyruara për çdo praktikë në tre tendera, duke qenë se këto mangësi janë konstatuar edhe nga Agjencia e Prokurimit Publik e cila me vendimin e saj nr. 403/2, datë 4.7.2013 drejtuar Komunës Rrashbull, ka dhënë masa

administrative (gjoba) anëtarëve të Njesisë së Prokurimit dhe të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, pra duke mbajtur parasysh këtë fakt dhe për të mos i dubluar masat, mbetemi me masat e dhëna nga APP, çështje kjo në proces gjyqësor nga personat e dënuar me gjobë dhe konkretisht:

H.G., Kryetar Komune me gjobë në masën 100,000 lekë, Anëtarët e Njesisë së Prokurimit: K.Ç. juriste, B.H. ekonomiste, I.S. pune sociale me gjobë në masën 100,000 lekë; Anëtarët e KVO:

B.S. Kryetar, B.S. anëtar, Q.L., anëtar me gjobë në masën 100,000 lekë.

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në Kontratën individuale të punës neni 9, shkronja (a) dhe (b), bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, i rekomandojmë Kryetarit të Komunës Rrashbull, që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për punonjësit si më poshtë:

**a. “Vërejtje”, bazuar në Kontratën individuale të punës shkronja (a), për 16 punonjësit si më poshtë:**

1. zj. K.Ç., me detyrë Juriste,
  2. z. B.K., me detyrë Drejtor i drejtorisë Taksë Tarifave Vendore,
  3. z. Q.L., me detyrë Përgjegjës Sektorit Bujqësisë,
  4. znj. A.M., me detyrë përgjegjëse e sektorit të administratës,
  5. znj. V.B., me detyrë ekonomiste e pagave,
  6. z. P.N., me detyrë inspektor të taksave të biznesit, si anëtarë i komisionit të inventarizimit,
  7. znj. I.S., anëtarë të komisionit të inventarizimit,
  8. z. Gj.P., anëtarë të komisionit të inventarizimit,
  9. znj. B.H., anëtarë të komisionit të inventarizimit,
  10. z. A.M. anëtar të komisionit të blerjeve me vlera të vogla,
  11. z. F.H. anëtar të komisionit të blerjeve me vlera të vogla dhe komisioni i vendosjes së normativave të konsumit,
  12. znj. H.Gj., me detyrë llogaritare –magaziniere,
  13. z. I.T., komisioni i vendosjes së normativave të konsumit,
  14. z. D.D., me detyrë inspektor të taksave të biznesit,
  15. z. K.Sh., me detyrë inspektor të taksave të biznesit,
  16. znj. S.R., me detyrë inspektor të taksave të biznesit.
- Për shkeljet cilësuar në trajtim të çështjeve sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit

**b. “Vërejtje me paralajmërim”, bazuar në Kontratën individuale të punës shkronja (b), për 8 punonjësit si më poshtë :**

1. z. S.S., me detyrë Kryetar i Degës Financës,
2. z. B.S., me detyrë drejtori i shërbimeve,
3. z. B.S., me detyrë Përgjegjës Sektori pyjeve kullotave dhe veprave ujore,
4. z. J.K., me detyrë inspektorë të taksës së tokës dhe të banesave, si anëtarë të komisionit të inventarizimit,
5. z. P.S., me detyrë inspektorë të taksës së tokës dhe të banesave, si eksperti mekanik komisioni i vendosjes së normativave të konsumit,
6. z. K.G., me detyrë inspektorë të taksës së tokës dhe të banesave,
7. z. S.D., me detyrë inspektorë të taksës së tokës dhe të banesave,
8. z. Sh.G., me detyrë inspektorë të taksës së tokës dhe të banesave.



**Shënim:** Nuk rekomandojmë masa disiplinore sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat ishin larguar nga puna dhe zbritur në detyre me urdhër të Kryetarit të Komunës, (për shkeljet të ndryshme), para se të fillonte auditimi, ndërkohë ata nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien, ndjekjen e zbatimin e tyre, për 2 personat si më poshtë;

1. **z.V.N.** ish Drejtor i urbanistikës,

2. **zj. M.T.**, me detyrë ish përgjegjëse e sektorit komunal deri datë 30.6.2013, aktualisht punëtore,

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte **“largim nga puna”**.

Për **2** ish drejtuesit e mësipërm, nga **Kryetari i Komunës** të njoftohet Departamenti i Administratës Publike për masat disiplinore me qëllim kryerjen e regjistrimeve të nevojshme në Regjistrin Qendror të Personelit.

Nga Komuna Rrashbull, me shkresën protokolluar në KLSH me nr. 309/10 datë 06.8.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

*Shënim:* Auditimi është kryer nga audituesit Selfo Zeneli, Vaso Peci, Mirosh Bogdo, Halil Isufi, Abdulla Duka dhe Besmir Paja më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**